

GRIDI ÇAÇA

Auditues Ligjor, me Nr. Licence 413, datë 31.05.2019

Adresa: Njësia Bashkiake nr.9, Rruga “Jordan Misja”, Ndërtesa 3, Kati II, Ap. D28, Tiranë

Tel: +355 68 40 23 541

Email: gridi.caca@yahoo.com

RAPORTI I TRANSPARENCËS PËR VITIN 2024

Tiranë, 2025

PËRMBAJTJA

SHKURTIME.....	3
1. HYRJE.....	4
2. PËRSHKIMI I STRUKTURËS LIGJORE DHE I PRONËSISË.....	5
3. SISTEMET E KONTROLLIT TË BRENDSHME TË CILËSISË.....	6
4. AUDITIMI I NJËSIVE ME INTERES PUBLIK.....	7
5. DEKLARATAT PRAKTIKE TË PAVARËSISË.....	8
6. INFORMACIONE FINANCIARE.....	9
7. TRAJNIMET E NDJEKURA PËR KUALIFIKIMIN E VIJUESHËM PROFESIONAL.....	10

SHKURTIME

AL - Audituesi Ligjor

KM - Kontabilist i Miratuar

IEKA - Instituti i Ekspertëve Kontabë të Regjistruar

BMP - Bordi i Mbikqyrjes Publike

AIF - Agjensia e Inteligjencës Financiare

NIPT - Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm

QKB - Qendra Kombëtare e Biznesit

NIP - Njësi me Interes Publik

SKK - Standardet Kombëtare të Kontabilitetit

SNRF - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

SNA - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

1. HYRJE

Referuar Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për auditimi ligjor, organizimin e profesionin të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, kreu VI, neni 45, audituesit ligjor dhe shoqëritë e auditimi që kryerjnë auditime të NIP janë të detyruar të hartojnë dhe të publikojnë brenda tre muajve pas mbylljes së vitit financiar raportin e transparencës.

Raporti i transparencës i refererohet shoqërisë “Gridi Çaçë” – Person Fizik dhe paraqet të gjithë veprimtarinë e tij për vitin financiar 2024.

Shoqëria “Gridi Çaçë” është studio auditimi ku ofrohen shërbimet e auditimit dhe shërbime të tjera financiare në përputhje me SKK-të, SNRF-të, SNA-të dhe kuadrat e tjera të zbatueshme të raportimit financiar, konkretisht:

- Auditimi i pasqyrave financiare dhe të gjitha llojet e shërbimeve sipas SNA-ve
- Shërbimet e kontabilitetit
- Konsulencë dhe shërbime tatimore
- Hartim dhe përgatitje të raporteve financiare mujore ose vjetore në përputhje me SKK-të apo SNRF-të
- Vlerësime, analiza dhe plane biznesi

2. STRUKTURA LIGJORE DHE E PRONËSISË

Referuar dispozitave të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, shoqëria është e regjistruar pranë QKB-së me NIPT: L91609010A. Vendi ku ushtrohet aktiviteti është në adresën “Njësia Bashkiake nr.9, Rruga Jordan Misja, ndërtesa nr.3, kati II, Ap. D28, Tiranë”.

Forma juridike është “Person Fizik” dhe zotërohet nga Z. Gridi Çaçë.

Z. Gridi Çaçë është i regjistruar si auditues ligjor, me license nr. 413, datë 31.05.2009.

3. SISTEMET E KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

Audituesi ligjor zbaton standardet më lëtë larta profesionale në të gjitha shërbimet që ai ofron për të ruajtur integritetin dhe reputacionin e tij dhe për këtë qëllim audituesi ligjor harton dhe zbaton politika dhe sisteme të cilësisë për të qenë në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e standardeve etike dhe me kërkesat e tjera rregullatore dhe ligjore.

Pavarësia është faktori kryesor për ofrimin e një shërbimi cilësor, prandaj në kemi hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura në lidhje me kontrollin e cilësë. Sistemi i kontrollit të cilësisë konsiston në vlerësimin dhe identifikimin e rrezikut dhe sistemin e monitorimit me qëllim që të sigurohet pajtueshmëria me standardet, ligjet dhe rregullat.

Pjesë përbërës e këryre sistemeve janë:

- Manualët teknike të kontrollit të cilësisë
- Edukimi dhe Kualifikimet e Vijnueshme Profesional
- Rishikimet e pavaruar nga auditues të tjerë të jashtëm të kualifikuar për qëllime të kontrollit të cilësisë të cilët kanë kriteret e mpëoshtme:
 - Kanë përvojën dhe kualifikimet e nevojshme
 - Kanë pavarësi të plotë nga audituesi që i nënshtrohet rishikimi
 - Janë anëtarë të IEKA-s

Bazuar në Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009, “Për audituesin ligjor, organizimin e profsionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ushtrohen kontrolle nga BMP dhe IEKA me qëllim dhënien e sigurisë për cilësinë e punës audituese.

4. AUDITIMI I NJËSIVE ME INTERES PUBLIK

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.01.2019, “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e prublikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”, gjatë viti 2024 janë audituar shoqëritë e mëposhtme të cilat janë klasifikuar si shoqëri me interes publik:

- 1- Klodi sha, me NIPT: J82916538N, Tiranë, me objekt veprimtarie “tregti”, e klasifikuar si shoqëri me interes publik për shkak të madhësisë së biznesit.
- 2- Alba Shoes Group shpk, me NIPT: L21624013A, Tiranë, me objekt veprimtarie “fasoneri”, e klasifikuar si shoqëri me interes publik për shkak të numrin të punëmarrëve.
- 3- Endi shpk, me NIPT: K04226215G, Krujë, me objekt veprimtarie “fasoneri”, e klasifikuar si shoqëri me interes publik për shkak të numrin të punëmarrëve.
- 4- Rafaelo 2002 sha, me NIPT: K22113003Q, Tiranë, me objekt veprimtarie “tregti”, e klasifikuar si shoqëri me interes publik për shkak të madhësisë së biznesit.
- 5- Agroblend sha, me NIPT: J61918010D, Vorë, me objekt veprimtarie “tregti”, e klasifikuar si shoqëri me interes publik për shkak të madhësisë së biznesit.

5. DEKLARATA E PAVARËSISË

Unë, Z. Gridi Çaçë, auditues ligjor, me nr. license 413, datë 31.05.2019, gjatë angazhimit tim të auditimeve për vitin 2024, kam qënë plotësisht i pavarur nga klientët të cilëve i kam audituar pasqyrat financiare, ku kam kërkuar ndalimin e ndikimit dhe të ndërhyrjeve të personave që kanë pozicione me influencë, si ortakët, administratorët, drejtorët, etj, të cilët kanë qënë në dijeni dhe kanë patur njohuri mbi pasqyrat financiare. Gjithashtu kam mënjanuar kërcënimet ndaj pavarësisë që mund të krijoheshin nga marrëdhëniet e ngushta me punonjësit, si drejtorët e financës, kontabilistët, etj.

Gjatë angazhimit të auditimit të pasqyrave financiare kam patur:

Pavarësi në të menduar – Duke nxjerrë konkluzionet pa u ndikuar nga influencat që kompromentojnë gjykimin tim profesional

Pavarësi në dukje – Duke shmangur çdo rrethanë, kërcënim apo person që ka patur dijeni mbi pasqyrat financiare që do të arrinte të më kompromentonin integritetin tim.

Për të garantuar pavarësinë, deklaroj se me klientin të cilit i kam audituar pasqyrat financiare:

- 1- Nuk kam patur avantazhe të veçanta nga shoqëritë
- 2- Me ortakët, administratorët, anëtarët e këshillit mbikqyrës nuk kam lidhje farefisnie apo krushqie
- 3- Nuk kam përfituar asnjë pagë apo shpërblim tjetër nga ortakët apo administratorët
- 4- Nuk kam qënë i punësuar më parë në shoqërinë që kam audituar

Referenca: Kam lexuar dhe jam njohur me kushtet dhe rrethanat që janë të përshkruara në manualin e Kodit Ndërkombëtar të Etikës për profesionistët kontabël të IFAC (ku janë përfshirë dhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë), pjesa 4A , “Pavarësia për angazhimet e auditimit dhe të rishikimit”, dhe mendoj se kam qënë në përputhje me kërkesat e parashkuara në këtë kod.

6. INFORMACIONE FINANCIARE

Gjatë vitit 2024 janë realizuar të ardhurat si më poshtë:

TË ARDHURAT 2024	
SHËRBIMI	(në mijë lekë)
Auditime NIP	1,920
Auditime Jo-NIP	4,710
Shërbime konsulence	1,340
TOTALI	7,970

Gjatë veprimtarisë së vitit 2024 janë audituar shoqëri që nuk janë me interes publik të cilat kanë objekt veprimtarie si më poshtë:

- a) 3 shoqëri operojnë në fushën e ndërtimit
- b) 4 shoqëri janë prodhuese
- c) 4 shoqëri operojnë në fushën e shërbimeve
- d) 8 shoqëri janë tregtare

7. TRAJNIMET E NDJEKURA PËR KUALIFIKIMIN E VIJUESHËM PROFESIONAL

Në kuadër të Edukimit dhe Kualifikimit të Vijueshëm Profesional, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Regjistruar (IEKA), në ambjentet e Hotel Tirana International ka zhvilluar trajnimet me temat e mëposhtme:

1. **18 Qershor 2024, ora 14.30 – 18.30**, tema: *“Kornizat ndërkombëtare rregullative për shërbimet e auditimit / Kodi i Etikës (IESBA) & Udhëzime Etike”* (4 orë)
2. **24 Qershor 2024, ora 09.00 – 13.00**, tema: *“Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 300 – Planifikimi i Auditimit të pasqyrave financiare; Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 330 – Përgjigjet e auditorit ndaj rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara.”* (4 orë)
3. **25 Qershor 2024, ora 09.00 – 14.00**, tema: *“E drejta e Auditimit; Auditimi i brendshëm i bazuar në risk - Perspektiva e re e riskut ligjor;”* (5 orë)
4. **25 Qershor 2024, ora 14.30 – 19.30**, tema: *“Vlerësimi i anomalive të identifikuara gjatë auditimit. / Vlerësimi i Evidencës së Auditimit / Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 500 – Evidenca e Auditimit”* (5 orë)
5. **01 Korrik 2024, ora 09.00 – 11.00**, tema: *“Standardet Ndërkombëtare të Kontrollit të Cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të pasqyrave financiare, dhe angazhime të tjera të sigurisë dhe shërbimeve të lidhura.”* (2 orë)
6. **16 Dhjetor 2024, ora 09.00 – 13.00**, tema: *“Kombinimi i bizneseve dhe Konsolidimi”* (4 orë)
16 Dhjetor 2024, ora 13.00 – 17.00, tema: *“Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 600 – Auditimi i Pasqyrave Financiare të Grupit të përditësuara (Konsiderata specifike përfshirë punën e auditorëve të Komponentit) (4 orë)*
7. **17 Dhjetor 2024, ora 09.00 – 13.00**, tema: *“Raportimi i Qëndrushmërisë dhe Audituesit Ligjor; • SNA 700; • SNA 705; • SNA 710; • SNA 700; • SNA 720”* (4 orë)
17 Dhjetor 2024, ora 09.00 – 13.00, tema: *“Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 200 - Objektivat e përgjithshme të auditorit të pavarur dhe performanca e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit; Standardi Ndërkombëtar i Auditimit 230 - Dokumentacioni i auditimit”* (4 orë)
8. **18 Dhjetor 2024, ora 09.00 – 11.00**, tema: *“Agjensia e Inteligjencës Financiare (Parandalimi i Pastrimit të Parave)”* (2 orë)
18 Dhjetor 2024, ora 11.00 – 13.00, tema: *“Përgjegjësia e Auditorit lidhur me mashtrimet në një auditim të pasqyrave financiare”* (2 orë)